



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0147**  
**Data e Vendimit: 22.03.2023**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 3 pika 1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 60 par 1 pika a) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., kundër Njoftimit e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor” me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 22/03/2023, mori këtë:

## Vendim

**Hedhet si e jashtafatshme**, ankesa e DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/0147, e datës 17/03/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

**I lejohet**, autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

## Arsyetim

Autoriteti kontraktues, Komuna e Prishtinës, me datën 28. 09. 2022, ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit: “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka publikuar me datën 08.03.2023 Njoftimin B54 (Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara), ku sipas këtij Njoftimi dhe dosjes së tenderit,

afati i fundit për ofertim ka qenë data: 20.03.2023.

Operatori ekonomik “Doctor Exterminator” DDD Sh.P.K, kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar me datën 15.03.2023, ora 16:23minuta, që llogaritet që kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 16.03.2023.

OE ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 17. 03. 2023 ka parashtruar ankesë në OSHP.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të lëndës, konform nenit 108/A paragrafi 3 pika 1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik për parashtrimin të kërkesave për rishqyrtim të miratuar nga KRPP-ja, Kryetarja e OSHP-së vlerëson se kërkesa për rishqyrtim e OE “Doctor Exterminator” DDD Sh.P.K është e jashtëafatshme, sepse sipas kësaj dispozite ligjore thuhet:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Operatori ekonomik ankues për këtë ankesë nuk ka paguar fare tarife. I njëjti në OSHP ka sqaruar se e ka dërguar gabimisht dy ankesa, sepse për këtë aktivitet të prokurimit poashtu ka parashtruar ankesën 142/23 për të cilën edhe ka paguar tarife. Andaj, Kryetarja e OSHP-se vlerëson se përveç se kjo ankesa është e jashtëafatshme, e njëjta nuk është parashtruar konform nenit 111. 10 të LPP-se dhe është e palejuar.

Andaj, duke u bazuar në sqarimin e dhënë sipas nenit përkatës, OSHP konsideron se ankesa e OE “Doctor Exterminator DDD Sh.P.K” është e jashtëafatshme sepse e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor në autoritet kontraktues, andaj konform nenit 117 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Këshillë juridike:**

**Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: